



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARKUT TIRANË
SEKTORI I PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT

Nr. 1324 prot.

Tiranë, më 04.06 .2018

LËNDA : Njoftim për vende të lira

Drejtorja Arsimore Rajonale e Qarkut Tiranë, bazuar në ligjin Nr.69, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 55, pika 1 dhe udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr.57, datë 12.11.2013 “Për procedurat e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar”, kreu 1, pika A, shpall konkursin për vendet e lira për pozicionin e drejtorit në institucionet publike të arsimit parauniversitar, si më poshtë:

1. Shkolla e mesme e bashkuar “ Feti Vogli” Baldushk
2. Shkolla 9- vjeçare Mëzes-Fushë
3. Gjymnazi “Myslym Shima” Yzberish
4. Shkolla 9-vjeçare Fushë-Prezë
- 5.Shkolla e mesme e bashkuar “ Shaban Sheshori”, Prezë
- 6.Shkolla 9-vjeçare Marqinet.

KËRKESA TË VEÇANTA PËR KANDIDATËT

Kandidati/ja për drejtor i institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet:

- a) të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të njëvlershme me të, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 "Per arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë),
- b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar",
- c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij.

DOKUMENTACIONI I APLIKIMIT

- a) Kërkesë me shkrim në lidhje me institucionin publik arsimor në të cilin, kandidati/ja kërkon të aplikoj,
- b) CV - në dhe kopjet që dëshmojnë pohimet në CV (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën Nr. 1, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.57, datë 12.11.2013),
- c) Tabelën e plotësuar me të dhënat për aplikant (Sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur udhëzimit Nr.57, datë 12.11.2013),
- ç) Dëshminë e penalitetit të lëshuar jo më herët se tre muaj para datës së aplikimit,
- d) Dy rekomandime nga mësues, drejtorë të institucioneve arsimore, ose titullarë të njësive arsimore vendore që kanë punuar me aplikantin gjatë viteve të fundit. (Sipas modelit të shtojcës nr. 3, bashkëlidhur Udhëzimit Nr.57, datë 12.11.2013).

Dokumentacioni për aplikim paraqitet në zarf të mbyllur.

Dorëzimi i dokumentacionit të aplikimit do të bëhet pranë Sekretarisë së Drejtorisë Arsimore Rajonale të Qarkut Tiranë, me adresë rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë, çdo ditë nga dita e hënë në të enjte nga ora 08:00 – 16:30 dhe ditën e premte nga ora 08.00 – 14.00.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të aplikimit do të jetë data 13 qershor 2018 ora 16.30.

DREJTOR

Englantina METANI

